



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Në bazë të nenit 16 paragrafit 1.2 të Ligjit Nr.06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Rregullore Nr. 02/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2021 për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve dhe Vendimit KGJK. Nr. 399/2023 datë: 21 shtator 2023, Këshilli Gjyqësor i Kosovës shpall:

KONKURS I BRENDSHËM
për zgjedhjen e anëtarit të
komisionit për vlerësimin e përformancës

- **një (1) gjyqtar i Gjykatës Supreme nga radha e gjyqtarëve nga komuniteti serb;**

KRITERET APLIKIMIT:

1. ka së paku pesë (5) vite përvojë pune në lëmin civile, penale, ekonomike dhe administrative;
2. nuk i është shqiptuar masë disiplinore gjatë pesë (5) viteve të fundit, përjashtimisht masës së qortimit, apo vërejtjes jopublike me shkrim;
3. nuk është duke u zhvilluar procedurë hetimore për shkelje të rëndë disiplinore;
4. nuk shërben si kryetar i gjykatës apo anëtar i Këshillit, përveç Kryetarit të Komisionit i cili është anëtarë me mandatë të plotë në Këshill, ose nuk shërben si Kryetar apo Kryesues i ndonjë institucioni tjetër; si dhe
5. është vlerësuar me notën “shkëlqyeshëm” ose së paku notën “shumë mirë” në vlerësimin e fundit të performancës.

TË DREJTË APLIKIMI:

1. gjyqtarët e Gjykatës Supreme nga radha e gjyqtarëve nga komuniteti serb;

MËNYRA E APLIKIMIT

Aplikacioni së bashku me dokumentet mbështetëse mund të dorëzohet në Zyrën e pranimit në Sekretariatën e KGJK-së :

- **në formë fizike** (i cili regjistrohet dhe secili kandidat pajiset me një konfirmim mbi pranimin e aplikacionit) dhe
- **përmes postës së rregullt**

FORMULARI I APLIKIMIT

- formulari mund të shkarkohet nga faqja zyrtare e KGJK-së. (www.gjyqesori-rks.org)

[Shkarko Aplikacionin](#)

AFATI I DORËZIMIT TË APLIKACIONEVE

Afati për dorëzimin e aplikacionit është tetë (8) ditë nga publikimi i konkursit:

Data e fillimit të aplikimi: 16 TETOR 2023

Data e fundit të aplikimit: 23 TETOR 2023

ADRESA:

- Sekretariati i KGJK-së,
- Rruga ‘Luan Haradinaj’ nr. 133, Prishtinë, në Zyrën e Pranimit.
- 10000 Republika e Kosovës